VENDIM
Nr.542, datë 22.8.2007

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR.35853/04, DATË 12.12.2006 TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN "BAJRAMI KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane "Për të drejtat e njeriut", ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e konventës europiane "Për të drejtat e njeriut dhe të lirive themelore"", dhe të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.35853/04, datë 12.12.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen "Bajrami kundër Shqipërisë" në shumën 25 000 (njëzet e pesë mijë) euro.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave.
3. Shuma prej 25 000 eurosh, së bashku me interesat e mospagimit në afat të depozitohen në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit "Bajrami", dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën kur do të çelet llogaria.
4. Fondi i përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, t'i shtohet Ministrisë së Financave, zëri "Shpenzime korente", dhe pagimi i shumës së depozituar të bëhet përkundrejt paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit
5. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha